



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Vaj Lubrifikant per Automjete”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09211100-2;
09211400-5; 09211500-6; 24951000-5

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 96592-08-18-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.231.840 (dy milion dyqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet) lekë pa Tvsh.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në SPE, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

2.1.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB):

- *Kodi:* VIII.1.A
- *Emertimi pershkrues i veprimtarisë:* Tregtim i Vajrave Lubrifikante

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, shkronja "a", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të ushtruar veprimtarinë profesionale përmes licencave, autorizimeve ose lejeve të lëshuara nga organet kompetente.

Kërkesa për disponimin e licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Kodi VIII.1.A – "Tregtim i Vajrave Lubrifikante", është në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencimin e veprimtarive ekonomike dhe synon të garantojë se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht të ushtrojë veprimtarinë që lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur dhe proporcional me objektin e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe siguron që kontrata të zbatohet nga subjekte që ushtrojnë aktivitetin përkatës në përputhje me kërkesat ligjore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse*

operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** me koston e tij, në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova që vërtetojnë aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Deklarata me anë të së cilës operatori ekonomik merr përsipër të kryejë transportin e mallrave me shpenzimet e veta deri në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore, kërkohet për të garantuar përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktore dhe furnizimin e mallrave në vendin e dorëzimit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën dhe siguron që ofertuesi të ketë kapacitetin organizativ për të realizuar shpërndarjen e mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi, me qira ose në huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi ose qira ose huapërdorim

Shenim 3.1: Për mjetet me status përdorimi qira/hua përdorje të disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit, huadhenesit dhe huapërdoresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve. Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesipër pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Ky kriter quhet i përmbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe në bazë të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit përfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve

provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

4. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuara. Në rastet e autorizimit nga distributori, duhet të vërtetohet lidhja që distributori ka me prodhuesin. Në autorizim duhet të jete i paraqitur Nr. i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet e nevojshme.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar nga prodhuesi është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", si dhe pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar.

Kjo kërkesë synon të provojë se operatori ekonomik disponon burime të sigurt dhe të autorizuar furnizimi për mallrat objekt prokurimi dhe ka aftësinë teknike e organizative për të realizuar kontratën. Autorizimi i prodhuesit ose i distributorit të autorizuar garanton origjinën dhe gjurmueshmërinë e produkteve, si dhe faktin që operatori ekonomik është i autorizuar të tregtojë produktet e ofruara dhe të sigurojë furnizimin e tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Në rast se autorizimi lëshohet nga distributori, kërkesa për të provuar lidhjen kontraktore ndërmjet distributorit dhe prodhuesit është e nevojshme për të verifikuar zinxhirin e autorizimit dhe për të shmangur paraqitjen e autorizimeve nga subjekte që nuk kanë të drejtë të përfaqësojnë prodhuesin. Kërkesa që në autorizim të pasqyrohet numri i referencës së procedurës së prokurimit, si dhe të dhënat identifikuese të prodhuesit/distributorit, i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vlefshmërinë e autorizimit dhe autenticitetin e tij. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është objektiv, proporcional dhe jodiskriminues, pasi synon të garantojë furnizimin me produkte origjinale, të certifikuara nga burime të autorizuar dhe realizimin e suksesshëm të kontratës në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

5. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesi Certifikatat ISO Si më poshtë:

5.1 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015 të prodhuesit, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jete e

vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Ofertuesit duhet te paraqesin Çertifikate ISO 14001:2015 të prodhuesit, te standartit ndërkombetar te menaxhimit te sistemit te mbrojtjes se ambjentit/mjedisit, te cilat do te garantonin mbrojtjen ndaj mjedisit, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 dhe Certifikatës ISO 14001:2015 të prodhuesit, dhe /ose te njevlefshme ,është vendosur në mbështetje të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga organe të pavarura për të provuar se mallrat prodhohen në përputhje me standardet e njohura të cilësisë dhe të menaxhimit mjedisor, duke pranuar edhe certifikata ose prova të tjera ekuivalente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa për Certifikatën ISO 9001:2015 të prodhuesit është vendosur për të garantuar se produktet objekt prokurimi prodhohen në një njësi prodhuese që zbaton një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar kontroll të proceseve të prodhimit, monitorimin e cilësisë, gjurmueshmërinë e produktit dhe përputhshmërinë e vazhdueshme me specifikimet teknike dhe standardet e prodhimit. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin me vajra lubrifikantë, kjo certifikatë përbën garanci se produktet janë prodhuar në kushte të kontrolluara dhe sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Kërkesa për Certifikatën ISO 14001:2015 të prodhuesit është vendosur për të garantuar se procesi i prodhimit të mallrave objekt prokurimi realizohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor, duke siguruar kontrollin e ndikimeve mjedisore, përdorimin e praktikave të përgjegjshme gjatë procesit të prodhimit dhe respektimin e kërkesave

të legjislacionit mjedisor. Duke pasur parasysh natyrën e produkteve objekt prokurimi, kjo certifikatë garanton se prodhuesi zbaton procese prodhimi që minimizojnë ndikimin në mjedis dhe sigurojnë një nivel të lartë të kontrollit gjatë prodhimit të vajrave lubrifikantë.

Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, janë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, pasi synojnë të garantojnë që mallrat e furnizuara të jenë prodhuar nga prodhues që zbatojnë standarde të njohura ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit, duke rritur besueshmërinë, cilësinë dhe sigurinë e produkteve që do të furnizohen autoritetit kontraktor.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize për secilin artikull objekt prokurimi, të lëshuar nga një laborator i akredituar. Fletët e analizës duhet të jenë të vlefshme dhe të jenë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, të llogaritura nga data e paraqitjes së ofertës.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e fletëve të analizës për secilin artikull objekt prokurimi, të lëshuara nga një laborator i akredituar, është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, me qëllim verifikimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për të siguruar furnizimin me mallra që përmbushin kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Paraqitja e fletëve të analizës së produkteve objekt prokurimi synon të garantojë që vajrat lubrifikantë të ofruar përmbushin parametrat teknikë dhe cilësorë të kërkuar, si dhe të sigurojë verifikimin e karakteristikave fiziko-kimike të produkteve nëpërmjet një vlerësimi të kryer nga një laborator i pavarur dhe i akredituar. Kërkesa që analizat të jenë lëshuar brenda një periudhe jo më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga data e paraqitjes së ofertës është vendosur për të garantuar që rezultatet e analizave të pasqyrojnë gjendjen aktuale dhe karakteristikat reale të produkteve që operatori ekonomik ofron në procedurën e prokurimit. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e mallrave objekt prokurimi, pasi vajrat lubrifikantë duhet të ruajnë parametrat teknikë, cilësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Kërkesa është objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, pasi zbatohet njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë dhe pranon analiza të lëshuara nga çdo laborator i akredituar, duke garantuar konkurrencë të drejtë dhe cilësi të produkteve të furnizuara.

7. Operatori Ekonomik Ofertues, ne ditën e hapjes së ofertave (perpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, prane NSHK Durres , duhet të paraqesë të protokolluara një moster për secilin ze të mallrave objekt prokurimi, sipas listës së kërkuar:

Tabela:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia	Sasia
1	Vaj Motorri SAE 10W40	Litra	1
2	Vaj Motorri SAE 15W40	Litra	1
3	Vaj Motorri SAE 20W50	Litra	1
4	Vaj Kamjo SAE 80W90	Litra	1
5	Vaj hidraulik ISO 46	Litra	1-20
6	Vaj hidraulik ISO 68	Litra	1-20
7	Antifrize	Litra	1
8	Alkol frenash	Litra	1
9	Graso	Kg	1
10	Vaj Motorri SAE 5w30	Litra	1
11	Vaj Motorri SAE 5w40	Litra	1
12	Vaj kamio ATF	Litra	1

- Mostrat e dorëzuara nga OE do të dorëzohen sipas specifikimeve të paraqitura nga AK, si dhe të shoqërohen me Skeden teknike përkatëse.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin artikull objekt prokurimi është përcaktuar në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6/a dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin artikull objekt prokurimi është vendosur për shkak të natyrës teknike të produkteve që kërkohen të furnizohen dhe nevojës për të verifikuar

përputhshmërinë e secilit produkt me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Më posht kemi argumentuar nevojën për sjelljen e seciles mostër objekt prokurimi:

1. Vajrat e motorit (SAE 10W40, SAE 15W40, SAE 20W50, SAE 5W30, SAE 5W40):

Paraqitja e mostrave për vajrat e motorit kërkohet për të verifikuar që produktet e ofruara përputhen me parametrat teknikë të kërkuar për lubrifikimin dhe mbrojtjen e motorëve të mjeteve. Vajrat e motorit me klasifikime të ndryshme SAE kanë karakteristika të ndryshme viskoziteti, sjellje në temperatura të ulëta dhe të larta, si dhe kërkesa të ndryshme sipas përdorimit. Për këtë arsye, çdo lloj vaji motori duhet të paraqitet më vete, në mënyrë që autoriteti kontraktor të verifikojë produktin e ofruar sipas specifikimeve të kërkuara.

2. Vajrat e kamios (SAE 80W90 dhe ATF): Paraqitja e mostrave për vajrat e kamios SAE 80W90 dhe ATF kërkohet për shkak se këto produkte përdoren në sistemet e transmetimit të mjeteve dhe kanë karakteristika teknike specifike të ndryshme nga vajrat e motorit dhe vajrat e tjerë lubrifikantë. Vaji i kamios SAE 80W90 përdoret kryesisht për sistemet e transmetimit mekanik, reduktorët dhe mekanizmat ku kërkohet mbrojtje ndaj presioneve të larta, konsumimit dhe ngarkesave mekanike, ndërsa vaji ATF është i destinuar për sistemet e transmetimit automatik dhe mekanizmat përkatës, ku kërkohen parametra specifike për funksionimin hidraulik, stabilitetin termik dhe kontrollin e fërkimit. Për shkak të ndryshimeve në funksion, përbërje dhe parametra teknikë ndërmjet këtyre dy produkteve, paraqitja e mostrave përkatëse mundëson verifikimin e secilit produkt në mënyrë të veçantë, duke garantuar që mallrat e ofruara përputhen me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Mostra mundëson verifikimin e përputhshmërisë së produktit me specifikimet teknike të kërkuara.

3. Vajrat hidraulikë ISO 46 dhe ISO 68: Paraqitja e mostrave për vajrat hidraulikë ISO 46 dhe ISO 68 kërkohet pasi këto produkte përdoren në sisteme hidraulike dhe duhet të përmbushin kërkesa specifike për viskozitetin, mbrojtjen ndaj konsumimit, stabilitetin termik dhe funksionimin korrekt të pajisjeve. Diferenca ndërmjet klasifikimeve ISO 46 dhe ISO 68 lidhet drejtpërdrejt me karakteristikat e punës së vajit, ndaj kërkohet verifikimi i secilit produkt sipas specifikimeve të kërkuara.

4. Antifrizë: Paraqitja e mostrës për antifrizën kërkohet për të verifikuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat teknike për mbrojtjen e sistemit të ftohjes së motorëve, përfshirë

rezistencën ndaj temperaturave ekstreme, mbrojtjen kundër korrozionit dhe përputhshmërinë me sistemet e përdorimit. Ky produkt ka funksion të ndryshëm nga vajrat lubrifikantë dhe kërkon verifikim të veçantë.

5. Alkooli i frenave: Paraqitja e mostrës së alkoolit të frenave kërkohet për shkak të rëndësisë së këtij produkti në sistemin e frenimit të mjeteve. Verifikimi i mostrës synon të garantojë që produkti i ofruar përmbush parametrat teknikë të kërkuar dhe është i përshtatshëm për përdorimin e përcaktuar, duke garantuar sigurinë dhe funksionimin korrekt të sistemit të frenimit.

6. Graso: Paraqitja e mostrës së grasos kërkohet për të verifikuar karakteristikat teknike të produktit, si konsistenca, aftësia lubrifikuese, rezistenca ndaj temperaturave dhe ngarkesave mekanike. Duke qenë se graso përdoret në pika të ndryshme lubrifikimi të mjeteve dhe pajisjeve, është e nevojshme të verifikohet që produkti i ofruar përputhet me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin artikull është vendosur në mënyrë proporcionale me natyrën e kontratës dhe shërben për të garantuar që çdo produkt i ofruar është konkretisht ai i kërkuar nga autoriteti kontraktor, duke shmangur furnizimin me produkte të papërshtatshme ose jashtë specifikimeve teknike. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, pasi të gjithë operatorët ekonomikë kanë të njëjtin detyrim për paraqitjen e mostrave dhe synon vetëm verifikimin objektiv të cilësisë dhe përputhshmërisë së mallrave.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIME PER VAJ LUBRIFIKANT (VITI 2026)

1. Specifikimet teknike Vaj Motorri SAE 10W40 , Norma :

API CI-4; ACEA E6/E7; MAN M3275-1; DTFR 15C100 (ish MB-Approval 228.31); MTU Category 2; Renault RLD-2/RXD.

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 10W-40
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	858
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	13–14
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	85–95
Indeksi i viskozitetit	Mbi 155
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 220
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -35
Nr. i bazicitetit (mg KOH/gr)	-
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
Përmbajtja e hirit (% m)	-
Viskoziteti në -17.8°C	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 12
Përmbajtja e ujit (%)	-

2. Specifikimet teknike Vaj Motorri SAE 15w40, Norma :

API CI-4, CH-4, CG-4, CF-4, CF, SL; ACEA E7, E5, E3; Caterpillar ECF-2/ECF-1A; Cummins CES 20078/77/76/75/72/71; Deutz DQC III; JASO DH-1; MAN M3275-1; DTFR 15C100 (ish MB-Approval 228.31); MTU Category 2; Renault Trucks RLD-2; Volvo VDS-3.

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 15W-40
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	885
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	15–16
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	110–120
Indeksi i viskozitetit	Mbi 142
Temperatura e flakerimit COC (°C)	Min. 220
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -35
Numri i alkalinitetit (TBN, mg KOH/g)	Mbi 11
Përmbajtja e ujit (%)	0 ose ≤ 0.05%

3. Specifikimet teknike Vaj Motorri SAE 20W50, Norma :

API CH4/CG4/CF4/CF/SJ, ACEA A3/B3, ACEA E5/E3/E2, MB 228.3, MAN 3275, VOLVO VDS-2, MTU TYPE 1, RENAULT RD/RD-2, CUMMINS CES 20076/20077, CAT ECF-1-a, ZF TE-ML-07C, MACK EO-M+

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 20W-50
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	891
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	17–18
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	145–165
Indeksi i viskozitetit	Mbi 120
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 230
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -30
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 8
Përmbajtja e ujit (%)	-

4. Specifikimet teknike Vaj Transmesioni 80w90 , Norma :

API GL-5, MIL-L-2105D, MB 235.0, ZF TE-ML 05A / 07A / 16B / 17B / 19B, MAN 342, FORD SQM-2C-9002 AA

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 80W-90
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	896
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	15–16
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	145–150

Indeksi i viskozitetit	Mbi 102
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 210
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -30
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 0.3
Përmbajtja e ujit (%)	-

5. Specifikimet teknike Vaj Hidraulik ISO VG 46, Norma :

Eaton E-FDGN-TB002-E;Parker Denison HF-0 /HF-1/HF-2;ISO 11158 HM;DIN 51524-2 (HLP);Bosch Rexroth Fluid Rating List RDE 90245

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	ISO VG 46
Densiteti në 15°C (kg/m³)	878
Viskoziteti në 100°C (mm²/s)	8–9
Viskoziteti në 40°C (mm²/s)	45–50
Indeksi i viskozitetit	Mbi 150
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 210
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -38
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 3
Përmbajtja e ujit (%)	-

6. Specifikimet teknike Vaj Hidraulik ISO VG 68, Norma :

Eaton E-FDGN-TB002-E;Parker Denison HF-0 /HF-1/HF-2;ISO 11158 HM;DIN 51524-2 (HLP);Bosch Rexroth Fluid Rating List RDE 90245

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	ISO VG 68
Densiteti në 15°C (kg/m³)	880
Viskoziteti në 100°C (mm²/s)	10–11
Viskoziteti në 40°C (mm²/s)	68–72
Indeksi i viskozitetit	Mbi 145
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 220
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -35
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 3
Përmbajtja e ujit (%)	-

7. Specifikimet teknike Antifrizë (Lëng kundër ngrirjes së ujit në radiatorë, me ngjyrë fluoreshente), Norma :

MB 325.2, MAN 324, GM 1899 M,FORD ESE M-97B44-A,JOHN DEERE H24B1/C1

Treguesit	Vlera
Përshkrimi	Antifriz (Lëng kundër ngrirjes së ujit në radiatorë, me ngjyrë fluoreshente)
Densiteti në 20°C	1.125
Alkaliniteti rezervë	20
Temperatura e kristalizimit (°C)	Jo më e lartë se -36°C

8. Specifikimet teknike Alkol Frenash , Norma :

SAE J1703 ,FMVSS 116 ,DOT 4 ,ISO 4925

Treguesit	Vlera
Lloji i lëngut	Alkol Frenash
Densiteti në 20°C (g/ml)	1.069
pH në 20°C	7.49
Alkaliniteti rezervë	-
ERBP (°C)	275
Pika e vlimit (°C)	187

9. Specifikimet teknike Graso , Norma :

Gras litiumi EP; klasë NLGI 2; viskozitet i vajit bazë ISO VG 220; me aditivë EP (Extreme Pressure); në përputhje me standardin DIN 51502 KPF2N-25 dhe ISO 6743-9 L-XBDEB 2; Temperaturë pune nga -20°C deri në +120°C.

Treguesit	Vlera
Pamja e jashtme:	Mase xhelatinoze uniforme pa kokrriza me ngjyrë të verdhë të çelët deri në kafe të hapët.
Tipi sapunit	Lithium
Kosinstenca N.L..G.I:	2
Penetracioni i punuar në 25°	265 -295
Korrozioni në pllakë bakri 100° C, %m	Reziston.
Temperatura e pikerenies , °C	Min 190
Temperatura e operimit , °C	-25 - > +160

10. Specifikimet teknike Vaj Motorri SAE 5W30 , Norma :

ACEA: A3/B4, ACEA: C3, MB 229.31, MB-Approval 229.51, VW 504.00 / 507.00, BMW Longlife-04

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 5W-30
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	858
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	12–13
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	70–75
Indeksi i viskozitetit	Mbi 170
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 210
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -36
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 13
Përmbajtja e ujit (%)	-

11. Specifikimet teknike Vaj Motorri SAE 5W40 , Norma :

API SM/CF, ACEA A3/B4, ACEA C3, MB-Approval 229.31, VW 502.00/505.00/505.01, BMW LongLife-04, FORD WSS-M2C917-A, RENAULT RN0700/RN0710, OPEL GM DEXOS2, CHRYSLER MS 10850, FIAT 9.55535-S2/M2/N2

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	SAE 5W-40
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	850
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	13–14
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	80–85
Indeksi i viskozitetit	Mbi 168
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 230
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -38
Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 7
Përmbajtja e ujit (%)	-

12. Specifikimet teknike Vaj Motorri Kambio ATF III , Norma :

MB 236.1 / 236.6 / 236.9 / 236.10, ZF TE-ML 04D / 05L / 14B / 16L / 17C, MAN 339, TYPE Z-2, ALLISON C-4

Treguesit	Vlera
Lloji i vajit	ATF III
Densiteti në 15°C (kg/m ³)	849
Viskoziteti në 100°C (mm ² /s)	6–7
Viskoziteti në 40°C (mm ² /s)	30–35
Indeksi i viskozitetit	Mbi 180
Temperatura e flakërimit COC (°C)	Min. 195
Temperatura e ngrirjes (°C)	< -50

Nr. i alkalinitetit (mg KOH/gr)	-
TBN (mg KOH/gr vaj)	Mbi 3
Përmbajtja e ujit (%)	-

1.Ambalazhimi dhe marketimi:

- Produkti duhet të jetë i ambalazhuar në fabrikë, në ambalazh origjinal të papërdorur dhe të përshtatshëm për ruajtjen, transportin dhe mbrojtjen e produktit nga dëmtimet gjatë manipulimit.
- Ambalazhi duhet të jetë metalik ose plastik, me mbyllje hermetike, të pajisur me tapë sigurie (tamper-evident) dhe vulë mbrojtëse (letër varaku/alumin ose sistem tjetër origjinal sigurie), e cila garanton se produkti nuk është hapur apo manipuluar.
- Në etiketën e ambalazhit duhet të jenë të shënuara qartë dhe në mënyrë të lexueshme të paktën: Emri tregtar i produktit, Tipi dhe viskoziteti i vajit, Miratimet (OEM Approvals) dhe specifikimet teknike përkatëse.
- Për të gjitha produktet, ambalazhimi duhet të jetë 1 (një) litër, me përjashtim të vajrave hidraulikë ISO VG 46 dhe ISO VG 68, për të cilët lejohen ambalazhe me kapacitet nga 1 litër deri në 20 litra, sipas ofertës së operatorit ekonomik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Argumentim Teknik: Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato janë përcaktuar mbi bazën e nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe kërkesave teknike të mjeteve dhe pajisjeve që disponon ndërmarrja për realizimin e shërbimeve të saj. Kërkesat teknike për secilin produkt janë përcaktuar me qëllim sigurimin e vajrave lubrifikantë të përshtatshëm për përdorimin në mjetet e ndërmarrjes, duke garantuar lubrifikimin e duhur, mbrojtjen nga konsumimi, ruajtjen e performancës së motorëve dhe pajisjeve, si dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së komponentëve mekanikë. Diferencimi i produkteve sipas kategorive dhe parametrave teknikë (vajra motori me viskozitet të ndryshëm, vajra transmisioni/kamioje, vajra hidraulikë, antifrizë, produkte për sistemin e frenimit dhe graso) është bërë për shkak se secili sistem i mjetit kërkon produkte me karakteristika të veçanta teknike dhe përdorim specifik. Përdorimi i produkteve jo të përshtatshme mund të ndikojë në funksionimin normal të mjeteve, të shkaktojë dëmtime mekanike dhe të rrisë kostot e mirëmbajtjes. Specifikimet teknike janë hartuar duke përcaktuar kërkesat minimale të nevojshme për funksionimin e mjeteve të ndërmarrjes dhe nuk tejkalojnë nivelin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të kontratës. Ato nuk janë orientuar drejt një marke apo prodhuesi të caktuar, por drejt parametrave teknikë dhe funksionalë që duhet të përmbushin produktet, duke garantuar konkurrencë të lirë ndërmjet operatorëve ekonomikë.